



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr. 184, datë 30.07.2020

**PËR ZGJATJEN E AFATIT PËR CAKTIMIN E SEANCËS DËGJIMORE NË LIDHJE ME PROCEDIMIN DISIPLINOR NDAJ PROKURORES**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenet 149, pika 1, 149/a, pika 1, germa “b”, të Kushtetutës, në nenet 100, pika 1, 138, pika 3, dhe 23, pikat 1 dhe 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa “a” dhe 190, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Disiplinor,

**V E N D O S I:**

1. Zgjatjen e afatit për caktimin e seancës dëgjimore deri në 2 (dy) muaj nga data 23.07.2020, që është dita e marrjes së dosjes nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në procedimin disiplinor nr. 251/31, dt. 21.07.2020 ndaj prokurores [redacted], me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë;
2. Zgjatja e afatit bëhet për të shmangur përkimin e datës së seancës dëgjimore me periudhën e pushimeve vjetore, në respektim të së drejtës ligjore të magistratëve për të marrë këto pushime gjatë muajit Gusht;
3. Ky vendim i njoftohet znj. [redacted] dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjehere dhe publikohet i anonimizuar në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETARI  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**



ANËTAR  
SANDËR BECI



ANËTAR  
VATË STAKA



ANËTAR  
TARTAR BAZAJ



ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

